15335

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 15335

# V E N D I M
## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 5. 7. 1996 une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi mora me shqyrtim kerkesen e kerkuesve Dede Pali dhe Pjerin Prendi, te cilet kerkojne te regjistrojne si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " **ALBMOBIL** " shpk dhe;

## K O N S T A T O V A:

**Se kerkuesit kerkojne te regjistrojne si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "ALBMOBIL" shpk, me seli ne Lezhe, Ish Ndermarrja e Grumbullimit, me kapital fillestar 100000 leke me ortak Dede Pali dhe Pjerin Prendi , me administrator Dede Pali, me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e** Mobilerise , tregtim e prodhim te lendes drusore, pajisje per zyra, pajisje shkollore, tregtim te mallrave industriale e ushqimore, me shumice e pakice, importi dhe eksporti si dhe ne fushen e transportit te mallrave si brenda dhe jashte vendit.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtare si dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

## V E N D O S A :

Te regjistroje si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "ALBMOBIL " me ortak me ortak Dede Pali dhe Pjerin Prendi , me administrator Dede Pali, me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e Mobilerise , tregtim e prodhim te lendes drusore, pajisje per zyra, pajisje shkollore, tregtim te mallrave industriale e ushqimore, me shumice e pakice, importi dhe eksporti si dhe ne fushen e transportit te mallrave si brenda dhe jashte vendit.

**Selia** e shoqerise do te jete ne me seli ne Lezhe , ish Ndermarrja Grumbullimit

**Me** kapital fillestar 100.000 leke.

**Kohezgjatja** e shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
/ ***Florina Tegu*** /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. ____________ Vendimit

# V E N D I M

## I GJYQTARIT TEVETEM

Ne Tirane sot me date 18 06.2002 une gjyqtare e gjykates se shkalles se pare Tirane ____________ mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ded Llesh Pali per depozitimin prane rregjistrit tregetar te Gjykates te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " ALBMOBIL " SHPK DHE

## K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr. 15335 date 05.07.1996 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare "ALBMOBIL " shpk me ortake Dede Pali dhe Pjerin Prendi, me administrator Dede Pali.

Me vendimin e asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie eshte vendpsur largimi nga kjo shoqeri e ortakut Pjerin Prendi duke ju shitur kuota e kapitalit te tij ne masen 49 % ortakut Dede Pali, qe ngelet i vetem.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

## V E N D O S A

Pranimin e kerkesees

Depozitimin prane rregjistrit tregetar te Gjykates te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " ALBMOBIL " shpk, ku eshte vendosur largimi nga kjo shoqeri e ortakut Pjerin Prendi duke ju shitur kuota e kapitalit ortakut qe ngelet i vetem ne kete shoqeri z. Dede Pali./

Depozitimin e kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit ./

Urdherohet Zyra e rregjistrit tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen 4/5 germa f,f si dhe te behet ndarja me vize te kuqe nga njeri rregjistrim tek tjetri.

GJYQTARE
/ R. Paluqja /

5 mijë

15335

# URDHER REGJISTRIMI

Me 1.

2.a. "Albamobil" Sh.P.K.

b. Lezhe rr. [illegible]

c. tregtimin e prodhimeve lende drusore exp-imp i mallrave te t ej

ç. 100 000 leke

3. Ortaku: [illegible] Pali, dtl. 1958, banues ne Lezhe

4. Statuti nenshkruar me date 05. 07. 1996
Ortaku i vetem

5. Data 05. 07. 1996

Statuti ka 5 Flete

Njoftime: a. shoqeria

b. dhomen e tregtise

c. organin perkates tatimor

d. zyren se statistikes

Publikime: +

GJYQTARE

(F. [illegible])

# KONTRATE

## E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "ALBMOBIL SHPK" SH.P.K.

### FORMIMI

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar e formalitete qe duhen plotesuar ne te me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e statutit qe I bashkohet kesaj kontrate ortaket:

1. Dede Pali, i biri i Lleshit, dtl. 1958, lindur dhe banues ne Lezhe, lagjja Beselidhja.
2. Pjerin Prendi, i biri i Nikolles, dtl. 1965, lindur e banues ne Lezhe.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALBMOBIL" shpk fiton personalitetin juridiknga dita e regjistrimit te saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te saj themeluese, si kjo kontrate dhe statuti I bashkohet dhe qe perben nje pjese te pandare te saj.

### SELIA

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ALBMOBIL SHPK" shpk eshte ne Lezhe, ish Ndermarrja Grumbullimit. Ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

### KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare eshte mbi 10 vjet.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare "ALBMOBIL SHPK" shpk eshte ne fushen e ;

*STATUT*

*I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALBMOBIL" SHPK SHPK*

*EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE KOHEZGJATJA*

*FORMIMI*
*NENI 1*

*Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar e formalitete qe duhen plotesuar ne te me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e kontrates qe i bashkohet ketij statuti ortaket:*

*1. Dede Pali, i biri i Lleshit, dtl. 1958, lindur dhe banues ne Lezhe, lagjja Beselidhja.*

*2. Pjerin Prendi, i biri i Nikolles, dtl. 1965, lindur e banues ne Lezhe.*

*Deklarojne se kane lidhur si me poshte vijon statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "ALBMOBIL" SHPK.*

*Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALBMOBIL" shpk fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te saj themeluese, si ky statut dhe kontrata qe I bashkohet dhe qe perben nje pjese te pandare te saj.*

*NENI 2*

*Selia e shoqerise me pergjegjegjesi te kufizuar "ALBMOBIL shpkshpk eshte ne Lezhe, ish Ndermarrja e Grumbullimit . Ajo gezon te drejten per te hapur filiale, dege apo agjensi te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit.*

*NENI 3*

*Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare ALBMOBIL SHPK shpk eshte mbi 10 vjet.*

*OBJEKTI I VEPRIMTARISE*
*NENI 4*

*Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise ALBMOBIL SHPK. Shpk eshte sa me poshte vijon :*

*- Ne fushen e mobileri ( tregtim e prodhim te lendes drusore), pajisje zyrash, pajisje shkollore, tregtim te mallrave industriale e ushqimore, me shumice e pakice, importi dhe eksporti si dhe ne fushen e transportit te mallrave si brenda dhe jashte vendit.*

*KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT*

*NENI 5*

*Kapitali themeltar i shoqerise tregtare "ALBMOBIL" shpk eshte 100.000 leke, kuotat e te cilit jane te ndara ne kete menyre ;*

*Z. Dede Pali zoteron 51 % te kapitalit fillestar*
*Z. Pjerin Prendi zoteron 49 % te kapitalit fillestar*

*Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra te tregtueshme. Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.*

*Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.*
*Me vendim unanim te Asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve kapitali baze mund te rritet me marreveshje te mevonshme nga ana e ortakeve, ne menyre proporcionale me kuotat e pjesemarrjes ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit baze me kuotat e tyre qe percaktojne ne kontraten e krijimit te shoqerise.*
*Kapitali shoqeror mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci duhet aprovuar brenda 4 muajve te ardhshem.*

NENI 6

Pjeset respektive te kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer teresisht nga ortaket duke u depozituar ne Banke, sipas vertetimit perkates qe i bashkohet ketyre akteve.

NENI 7

Per transferimin e kuotave te treteve ortaku duhet te njoftoje shkreserisht shoqerine, e cila brenda tre muajve, nga dita e marrjes dijeni duhet te jape vendimin lidhur sa me siper, vendim i cili nese nuk jepet ne kete afat liron nga detyrimi ortakun cedues.Ndersa nese ortaket e tjere pranojne te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes, kete duhet ta bejne brenda tre muajve, ne te kundert kuotat jane te lira t'u transferohen te treteve.

Nese do te lind nevoja per vleresimin e kuotave ortaket caktojne ekspert. Kur nje gje e tille nuk arrihet me marreveshje mes tyre, me kerkesen e njerit prej tyre, caktimi i ekspertit behet me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane.

ORGANET E SHOQERISE

NENI 8

Asambleja e Ortakeve eshte organi me ilarte i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ALBMOBIL" shpk. Asambleja mblidhet ne mbledhjet e saj te zakonshme e te jashtezakonshme.

Ne mbledhjet e zakonshme ajo shqyrton e vendos per ceshtje te tilla si emerim apo shkarkim i administratorit, eksperti, kontabilist te autorizuar dhe likuidues, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, ndarja e fitimit etj. Administrator i shoqerise do te jete z. Dede Pali.

Ne mbledhjet e saj te jashtezakonshme Asambleja e Ortakeve vendos per ceshtje te tilla si ndryshimet e statutit, zvogelimin e kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise ekonomike te shoqerise apo likuidimin e saj.

NENI 9

*Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALBMOBIL " shpk vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta dhe detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj.*

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 10

*Shoqeria tregtare ALBMOBIL SHPK.Shpk eshte prone e te dy ortakeve ALBMOBIL ku vepron per drejtimin e saj Asambleja e Ortakeve. Administrator i shoqerise do te jete z. Dede Pali .*

NENI 11

*Shoqeria tregtare ALBMOBIL SHPK shpk deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe Akti i Themelimit te saj si dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me njohjen e saj si person juridik nga Gjykata e Rrethit Tirane dhe me regjistrimin si subjekt privat ne organin perkates tatimor.*

NENI 12

MARREDHENIET E PUNES

*Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtje qe kjo kontrate nuk i parashikon zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.*

SEKRETI I PUNES

NENI 13

*Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise. Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga kjo shoqeri.*

KONTROLLI I BRENDSHEM

NENI 15

*Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te autorizuar, i cili eshte pergjegjes perpara kesaj shoqerie per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregulle e detyres se tij.*

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

### NENI 16

*Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti . Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet I jepet per perdorim Ortakeve te shoqerise.*

### NENI 17

*Pasuria e shoqerise eshte lirisht e trashegueshme ne rruge trashegimie.*

## SHPERBERJA E SHOQERISE

### NENI 18

*Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku. Ne rast mbylljeje Asambleja e Otakeve vendos mbi menyrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat. Ne rastin e likuidimit emertimi I shoqerise do te shoqerohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER, ku behet publikimi i saj. Mbasi behet njoftimi I mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqeria cregjistrohet nga regjistri tregtar i asaj gjykate.*

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### NENI 21

*Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga Vendimet e Asamblese se Ortakeve. Statuti perpilohet ne 4 kopje per t'iu shperndare organeve kompetente per regjistrimin e saj si person juridik dhe si subjekt privat.Nje kopje e tij do te mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.*

*ORTAKET E SHOQERISE*

062P31. DEDE PALI

PJERIN PRENDI

15335/1

18.06.02

Lezhe, me 11.06.2002

K E R K E S E

P E R P A R A:

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

T I R A N E

KERKUESI: Ded Pali, i biri Lleshit dhe i Daves, i vitlindjes 1958, banues ne Lezhe, administrator i shoqerise tregtare "Albmobil" "Shpk Lezhe, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepr an.

OBJEKTI: Depozitimin prane Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "Albmobil" Shpk Lezhe e te kontrates se shit kuotash.

Baza Ligjore: Ligji nr.7638,dt.19.11.1992 e Ligji nr.7667,dt.28.1.1993

I nderuar Zoti Kryetar,

Jam banor i qytetit Lezhe, por shqyrtimi kerkeses eshte ne juridiksionin e Gjykates se Rrethit Tirane.

Kerkoj depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit te asambles se ortakeve te shoqerise e te kontrates se shitjes se kuotave, sepse:

Me vendimin nr.15335,date 5.7.1996, eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "Albmobil" Shpk me seli ne Lezhe, me ortake te perbashket Dede Pali e Pjerin Prendin.

Me vendimin nr.9,date 10.6.2002 te asamblese se ortakeve te kesa shoqerie eshte vendosur te largohet nga shoqeria ortaku Pjerin Prendi dhe njeherazi ky ortak shet kuoten e kapitalit ne masen 49 per qind ortakut mbetes Dede Palit.

Ne keto rrethana, mbeshtetur ne ligjet e sipercituar, kerkoj te depozitoje vendimin e asamblese dhe kontraten e shitjes se kuotave prane Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Lezhe.

Prova shkresore: Vendimi i asamblese se ortakeve e kontrata e shitjes se kuotave.

PULLE TAKSE 100 LEKE

K E R K U E S I

Dede PALI

ALB-MOBIL:*SHPK IMPORT - EKSPORT (LEZHE)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E RRETHIT LEZHE
Nr. 763 Rep.

Lezhe, me 11.06.2002

V E R T E T I M

Vertetoj se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi Dede Pali per depoz timin e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise "Albmobil" Shpk i njohur prej meje, u nenshkruan ne prezencen time, dhe une noteria e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E
Merjeme I.DELISHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE "ALBMOBIL" SHPK

Lezhe, me 10.06.2002

# V E N D I M

## Nr.9, DATE 10.6.2002

## I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGTARE "ALBMOBIL" SHPK

Ne asamblea e ortakeve te Shoqerise Tregtare "Albmobil" Shpk Lezhe, e perbere nga ortaket Dede Llesh Pali e Pjerin Nikoll Prendi, ne mbledhjen e dates 10.06.2002, pasi shqyrtuam kerkesen e ortakut Pjerin Prendi, unanimisht dhe pa verejtja u,

V E N D O S:

1. Largimi nga Shoqeria Tregtare "Albmobil" Shpk i ortakut Pjerin Prendi.
2. Shitja e kuotes se kapitalit te tij ne masen 49 per qind ortakut Dede Palit.
3. Depozitimin e vendimit prane Regjistrit Tregtar ne Gjykaten E Rrethit Gjyqesor Tirane.

Mbledhja u mbyll me kete rend dite.

Lezhe, me 10.06.2002.

ORTAKET E SHOQERISE TREGTARE "ALBMOBIL" SHPK

Dede PALI    Pjerin PRENDI

ALB-MOBIL:*SHPK
IMPORT - EKSPORT
(LEZHË)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E RRETHIT LEZHE
Nr. 762 Rep.

Lezhe, me 11.06.2002

# V E R T E T I M

Vertetohet se vendimi i asamblese se ortakeve te Shoqerise Tregtare "Albmobil" Shpk, Dede Llesh Pali e Pjerin Nikoll Prendi, t njohur prej meje, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepru e nenshkruan ne prezencen time, dhe une noteria e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E

Merjeme I. DELISHI

PULLE TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISE

KERKESE

KERKUESI : 1.Dede Pali, i biri i Lleshit, dtl. 1958, lindur dhe banues ne Lezhe, lagjia Beselidhja.

2. Pjerin Prendi, i biri i Nikolles, dtl. 1965, lindur e banues ne Pezhe

15335

BJEKTI : Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ALBMOBIL"shpk ne baze te nenit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare

*PERPARA GJYKATES SE RRETHIT*

TIRANE

**Ne kerkuesit kemi krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar ALBMOBIL shpk, me ortak me ortak Dede Pali dhe Pjerin Prendi , me administrator Dede Pali, me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e** Mobilerise , tregtim e prodhim te lendes drusore, pajisje per zyra, pajisje shkollore, tregtim te mallrave industriale e ushqimore, me shumice e pakice, importi dhe eksporti si dhe ne fushen e transportit te mallrave si brenda dhe jashte vendit. Me seli ne Lezhe, ish Ndermarrja e Grumbullimit, kapital 100.000 leke.

**Kerkojme qe kjo shoqeri te regjistrohet prane Zyres se Regjistrit Tregtar ne Gjykaten tuaj.**

*KERKUESIT*

062P31 *Dede Pali dhe Pjerin Prendi*

*REPUBLIKA E SHQIPERISE*
NOTERIA TIRANE
Nr. 7321 Kol.
Nr.________Rep.

VERTETIM

Vertetojme se sot me date 5. I 1996 para meje noteres u paraqit kerkuesit Dede Pali dhe Pjerin Prendi , per identitetin e te cilieve pasi u sigurova ndermjet pasaportave perkatese, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se kane nenshkruar kerkesen e mesiperme dhe nenshkruan para meje noteres dhe une ne baze te ligjit e vertetova rregullisht.

PULLE TAKSE 10 LEKE RESHQIPERISE

NOTERE ... SHAHU